

VENDIM
Nr. 391, datë 3.4.2013

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 418, DATË 27.6.2012 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLAVE,
BORDEVE OSE KOMISIONEVE TË NJËSIVE TË QEVERISJES QENDRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, me propozimin e Ministrit të Financve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 3 dhe që i bashkëlidhet vendimit nr. 418, datë 27.6.2012 të Këshillit të Ministrave, në emërtesën e bordit/këshillit/komisionit në funksion të Këshillit të Lartë të Drejtësisë shtohet Komisioni i Mbrojtjes së Gjyqtarëve. Ky komision përbëhet nga 1 kryetar dhe 4 (katër) anëtarë me të drejtë pagese në masën 5 000 (pesë mijë) lekë për çdo pjesëmarrje në mbledhje, por jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) pagesa në një vit buxhetor.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha